1. Tabela e përputhshmërisë

Acquis e BE-së që synohet të përafrohet: Direktiva e Këshillit 2006/112/KE e 28 nëntorit 2006 "*Mbi sistemin e përbashkët të tatimit mbi vlerën e shtuar*", të ndryshuar. ***Shënuar tek kolona e referencës me numër 1.***		Titulli i projektaktit "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 92/2014, 'Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë', i ndryshuar*". Shkalla e përafrimit: E plotë				
1	2	3	4	5	6	7
Neni	Teksti	Referenca	Neni	Teksti	Përputhshmëria	Shënime
Nenet 96 dhe 97	**Neni 96** Shtetet Anëtare aplikojnë një normë standarde të TVSH-së, e cila përcaktohet nga çdo Shtet Anëtar si përqindje e bazës së tatueshme dhe e cila është e njëjtë si për furnizimin e mallrave, ashtu edhe për furnizimin e shërbimeve. **Neni 97** Norma standarde nuk duhet të jetë më e ulët se 15%.	1	**Neni 48** "Shkalla standarde"	Togfjalëshi "*...20 për qind.*" zëvendësohet me togfjalëshin "*...21 për qind.*".	E plotë	Ndryshimi i nenit 48 konsiston në ndryshimin e shkallës standarde të TVSH-së, nga 20% në 21%. Ky nen ndryshohet si më poshtë: Neni 48 **Shkalla standarde** Shkalla standarde e tatimit mbi vlerën e shtuar për furnizimet e mallrave dhe shërbimeve, e cila aplikohet si një përqindje e vlerës së tatueshme, është 21 për qind.
Neni 98 (1)	**Neni 98** 1. Shtetet Anëtare mund të aplikojnë maksimumi dy norma të reduktuara. Normat e reduktuara caktohen si përqindje e bazës së tatueshme, e cila nuk duhet të jetë më e ulët se 5% dhe zbatohen vetëm për furnizimet e mallrave dhe shërbimeve të renditura në Shtojcën III. Shtetet Anëtare	1	**Neni 49** "Shkallët e reduktuara"	1. Në pikën 3, togfjalëshi "*...6 për qind.*" zëvendësohet me togfjalëshin "*...10 për qind.*". 2. Në pikën 4, togfjalëshi "*...6 %...*" zëvendësohet me	E plotë	

	mund t'i aplikojnë normat e reduktuara për furnizimet e mallrave ose shërbimeve që përfshihen në maksimumi 24 pika të Shtojcës III. SHTOJCA III LISTA E FURNIZIMEVE TË MALLRAVE DHE SHËRBIMEVE PËR TË CILAT MUND TË APLIKOHEN NORMAT E REDUKTUARA DHE PËRJASHTIMI ME TË DREJTË ZBRITJEJE TË TVSH-SË, TË PËRMENDURA NË NENIN 98 (1) Artikuj ushqimorë (përfshirë pijet, por duke përjashtuar pijet alkoolike) për konsum njerëzor dhe shtazor; kafshë të gjalla, fara, bimë dhe përbërës që zakonisht synohen të përdoren në përgatitjen e artikujve ushqimorë; produkte që zakonisht përdoren si shtesë në artikujt ushqimorë ose si zëvendësues për artikujt ushqimorë; (12) akomodimi i ofruar në hotele dhe objekte të ngjashme, përfshirë ofrimin e akomodimit për pushime dhe dhënien me qira të hapësirave në kampe ose zona për karvane; (12a) shërbimet e restoranteve dhe kateringut, me mundësinë e përjashtimit të furnizimit me pije (alkoolike dhe/ose joalkoolike);			togfjalëshin "*...10 %...*". 3. Pas pikës 10, shtohet pika 11 me këtë përmbajtje: "*11. Shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet për furnizimin e produkteve ushqimore, si bukë dhe miell; qumësht dhe kos natyral; vezë; oriz; makarona; vaj ushqimor; mish pule; mish viçi/derri; peshk bazë; fruta të freskëta; perime të freskëta; bishtajore; sheqer; ushqime bazë për foshnja, është 6 për qind. Lista e detajuar e produkteve ushqimore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.*".		